



Konferenca Rinore Beograna


Sfidat e Edukimit për Shqipërinë dhe Serbinë, parë nga perspektiva e të rinjve

Rezultate dhe Rekomandime

Shqipëria Serbia

Leari Kola
Mariola Qesaraku
Joleza Koka
Jovana Majstorovic
Arnold Grabocka
Aleksandra Bozic
Romildo Kokthi
Predrag Stankovic

Denada Male
Stefan Josimov
Sonil Frashëri
Stefan Simic
Alban Nako
Milica Glisic
Alban Avdullai
Boris Popovic



**FRIEDRICH
EBERT
STIFTUNG**

Konferenca Rinore Beograna

Sfidat e Edukimit për Shqipërinë dhe Serbinë, parë nga perspektiva e të rinjve

Rezultate dhe Rekomandime

Nga Konferenca Rinore
Beograna

(5 – 7 Korrik, 2014)

Rezultate dhe Rekomandime nga Konferenca Rinore Beograna

**Sfidat e Edukimit për Shqipërinë dhe Serbinë,
parë nga perspektiva e të rinjve**

Publikimi i kësaj broshure u mundësua nga:

“Friedrich Ebert” Foundation

Tirana office

Rr: “Abdi Toptani”, Torre Drin, Kati 3-të, Kutia Postare 1418

Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 04 2250986 / 2273306; Fax: +355 04 2262067

www.fes-tirana.org

Viti i Publikimit: 2014

Përkthyer nga: Arnold Grabocka, Xhoi Malësia

Edituar nga: Arnold Grabocka

*Publikimet e FES-it nuk mund të përdoren për arsye komerciale
pa miratim me shkrim.*

Pasqyra e Lëndës


Parathënie: Leart Kola Nën Sekretar për Rininë në Partinë Socialiste	4
Mariola Qesaraku Kordinatore Programi	8
Joleza Koka Kryetare e Forumit Rinor Eurosocijalist të Shqipërisë	10
Jovana Majstorovic Marrëdhënie Ndërkombëtare – Rinia Demokratike e Serbisë	12
Arnold Grabocka Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë	13
Aleksandra Božić Rinia Demokratike e Serbisë	15
Romildo Kokthi Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë	17
Predrag Stankovic Rinia Demokratike e Serbisë	20
Denada Male Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë	22
Stefan Josimov Rinia Demokratike e Serbisë	24
Sonil Frashëri Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë	25

Stefan Simic Rinia Demokratike e Serbisë	27
Alban Nako Forumi Rinor Eurosocialist i Shqipërisë	28
Milica Glisic Rinia Demokratike e Serbisë	30
Alban Avdullai Forumi Rinor Eurosocialist i Shqipërisë	32
Boris Popovic Rinia Demokratike e Serbisë	34

PARATHËNIE

Leart Kola

**Nën Sekretar për Rininë
në Partinë Socialiste**



Konferenca dypaleshe e organizuar ne Korrik mes Forumit Rinor te Partise Socialiste te Shqiperise, e atij te Partise Demokratike te Serbise, me mbeshtetjen e FES (Friedrich Ebert Stiftung), mund te themi qe ishte paranteza e nje fillimi te ri mes dy vendeve Ballkanike. Te dyja Partite komunikojne prej vitesh tashme si pjese e Internacionales Socialiste, komunikim ky, qe ne menyre institucionale te dy vendeve i mungonte prej 68 vjetesh.

Tema e kesaj konference, e cila reflektohet dhe ne punimet e ketij materiali, te realizuara nga antaret e te dy forumeve, me shume se e zgjodhem ne si organizatore, na zgjodhi ajo ne, e diktuar kesisoj nga kushtet e kohes dhe nga aspiratat e te dy vendeve per tu bere pjese me te drejta te plota ne Bashkimin European.

Arsimi dhe sfidat e tij, qe ne fakt jane

sfidat tona, te te rinjve jo vetem te Shqiperise e Serbise por te gjithë Ballkanit, u bene pjese e tre diteve thellim dhe kritike, nga kushtet e teorise social-demokrate qe ne na perbashkon. A eshte Arsimi sot ne ballkan nje ure drejt zhvillimit apo nje pengese qe duhet reformuar sa me shpejt? A jemi ne te arsimuar per te perballuar konkurrencen e nje hapësire te perbashket punesimi, apo do mbetemi te marginalizuar akoma me shume nderkohe qe bejme hapa perpara ne njehesimin e tregut te punes me Europen? Ne mendimet e shkruara ne kete material, ndoshta nuk do gjeni nje manual me hapat e sakte se si arrihet ne pergjigjet e ketyre pyetjeve, e megjithate do gjeni dicka akoma me te rendesishme, hapin e pare, te ketyre te rinjve per te marre pergjegjesite e medha qe shtrihen perpara ne ndertimin e Gjenerates Tjeter.

E rendesishmja e ketij takimi, ishte mbi te gjitha jo vetem mundesia per tu njohur e per te njohur problemet e njeri tjetrit ne kete fushe, por mbi te gjitha per te shfrytezuar mundesite qe forumet Rinore te Partive politike kane per te influencuar ne shtetet respektive, shume here me shume se organizatat e shoqerise civile. Beograna eshte ne fakt, shembulli i gjalle i kesaj, ku te gjitha idete qe do lexoni ne kete material, i jane dorezuar ne forme propozimesh politike te dyja qeverive te dy vendeve.

Tamam si ne nje trill Bergsonian ku koha dhe hapësira nuk jane perfundimisht te sqaruara, do shihni qe shume prej fjaleve te shkruara te ketyre studenteve qe u bene pjese e kesaj konference, do duken sikur jane shkruar pas takimit historik te Kryeministrave te Shqiperise e Serbise, e ne fakt, jane shkruar plot 4 Muaj para ketij takimi, si per te vertetuar qe ajo qe na bashkon eshte shume me e forte se ajo qe na ndan, e per mendjet progresiste, si keto te se majtes se re, kufijte nuk jane fundi i nje influence politike, por fillimi i mundesive fantastike per bashkepunim dhe per zhvillim te metejshem.

Marreveshja per ceshtjet e Rinise e bere ne takimin e Beogradit mes Kreministrave Rama dhe Vucic, e cila tashme ka bere te mundur qe diplomat

e Universitetit te njihen nga te dy vendet, ku mbeshketen shkembimet Studentore, e ku te rinjte e te dyja vendeve do ndertojne bashkarisht forumin e pare ballkanik Rinore me ndermjetesimin e Shqiperise e Serbise qe do lehtesoje jo vetem nderimin e projekteve te perbashketa kulturore, por dhe thithjen e fondeve per Rinine nga Bashkimi European, na detyron NE qe te vazhdojme ne rrugen e komunikimeve mes forumeve politike, per te shpeshtuar e shpejtuar bashkerendimin politik ne te mire te rinise jo vetem mes Serbise dhe Shqiperise, por mes te rinjve ne gjitha ballkanin.

Forca politike, qe ne si forume rino-re, marim nga kjo marreveshje, eshte nje sinjal, jo vetem per te vazhduar lobimin ne te gjitha nivelet e strukturave te partise, por mbi te gjitha per te mare te ardhmen ne duart tona. Rinia, tregoj, qe eshte ura me e forte e komunikimit nderballkanik, e kesaj pjese te Europes e Botes, qe peng e nje historie ksenofobe e raciste, eshte duke hequr kete pluhur shpatullash, ne vitin e pare te paqes ne rajon.

Rinia, forumet politike te prezantuara ne kete material, por dhe te tjere, jane garancia jo vetem e paqes si nje parakusht i zhvillimit ekonomik, por dhe shkeputja perfundimtare nga

paranojat e nje rajoni qe nuk mund te mbetet peng as e partizaneve e as viktimave te tyre, as e lufrave mesjetare e as liderave qe jetojne akoma ne mesjete.

Ne duam e jemi te angazhuar qe te ndertojme nje sistem arsimor, qe te nderlidhet me tregun European te punes, per te shmangur marginalizmin

e rinise ballkanike. E po ashtu, forcimin e shtetit qe prodhon, per te integruar te rinjte ne zinxhirin zhvillimor, sepse besojme qe nje i ri qe merr edukimin e duhur, e punon per te ardhmen e tij, eshte nje garanci per nderimin e perspektives europiane ne Ballkan.

Ne jemi gati.

Mariola Qesaraku

Kordinatore Programi



Një nga fushat kryesore të punës së Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) në vendet e Ballkanit ka qenë bashkëpunimi rajonal. Që prej viteve, 90, mbështetja ka konsistuar në ndërtimin e fqinjësisë së mirë dhe për një bashkëpunim të vazhdueshëm. Bashkëpunimi rajonal ka qenë prioritet gjithashtu për aktorë të ndryshëm, ku një nga më të rëndësishmit është Bashkimi Evropian. Duke qenë se konsiderohet si një gur themeli për integrimin e rajonit në BE, bashkëpunimi rajonal në rastin e Ballkanit Perëndimor është nxitur kryesisht nga aktorët e jashtëm. Pronësia lokale e çështjeve të veta dhe gjetja e zgjidhjeve për sfidat e përbashkëta do të reflektonte pjekuri politike të këtyre vendeve dhe do ti sillte ato më pranë familjes së BE-së. Megjithatë, ndërsa bashkëpunimi rajonal në fusha të ndryshme si tregtia, energjia, infrastruktura, drejtësisë dhe punët e brendshme,

bashkëpunimin ndërkufitar etj po ecin në mënyrë graduale, bashkëpunimi politik sidomos në nivel dypalësh ka patur luhajtje të vazhdueshme. Sidomos problematike ka qenë rasti mes Shqipërisë dhe Serbisë.

Duke patur parasysh këtë sfond, bashkëpunimi mes të rinjve të forumeve të partive politike është një fillesë e shkëlqyer për rritjen e partneritetit. Projekti BEOGRANA, një iniciativë e Friedrich-Ebert-Stiftung në Tiranë në bashkëpunim me zyrën e FES-it në Beograd, ofroi një forum diskutimi për të rinjtë për të shkëmbyer ide, për të identifikuar interesa të përbashkëta dhe se si ata mund të bëhen agjentë ndryshimi.

Konferenca hulumtoi sfidat e përbashkëta të të rinjve shqiptarë dhe serbë në fushat e tregut të punës, sistemin arsimor dhe trajnimit, njohjen reciproke të diplomave dhe përmirësimin e kapaciteteve të

kërkimit dhe inovacionit në rajon.

Kjo konferencë përmirësoi dialogun ndërkulturor ndërmjet të rinjve nga Shqipëria dhe Serbia, kontribuoi në tejkalimin e stereotipeve ekzistuese dhe fushat e identifikoi fushat e bashkëpunimit dhe iniciativa të përbashkëta për shkëmbime të mëtejshme. Të rinjtë kuptuan se ata përballen me probleme dhe sfidat të njëjta, dhe ka më shumë gjëra që i bashkojnë sesa i ndajnë.

Publikimi që rezultoi nga Konferenca ofron një kuadër më të qartë të sfidave të përbashkëta që të rinjtë

në të dy vendet përballen. Një nga pikat kryesore të diskutimeve të tyre ishte rëndësia e bashkëpunimit rajonal, në interes të të dy vendeve në përgjithësi dhe veçanërisht për të rinjtë. Ndërtimi i rajonit është një proces brenda-jashtë; ky proces duhet të jetë i bazuar në iniciativat e aktorëve nga brenda rajonit, dhe të rinjtë mund të jetë një aktor vendimtar. Pjesëmarrësit ndanë opinionin e përbashkët për nevojën për një Ballkan me më shumë harmoni dhe dinjitet.

Joleza Koka

**Kryetare e Forumit Rinor
Eurosocijalist Shqiptar**



Konferenca Rinore Beograna u konceptua si një aktivitet i përbashkët mes Forumit Rinor Eurosocijalist të Shqipërisë dhe Rinisë Demokratike të Serbisë, falë ndihmës së madhe të Friedrich Ebert Stiftung. Kur menduam për organizimin e kësaj konference, nuk e bëmë nga hiçi. Disa kushte shumë specifike na sollën deri këtu. Së pari, vëzhguam një nevojë të përgjithshme për marrëdhënie më të mira mes dy shteteve, të cilat janë forca të fuqishme në Gadishullin Ballkanik. Historia ka gjymtuar këtë rajon, dhe politika shpesh nuk harron. Ne duhet ta ndërrojmë këtë traditë.

Së dyti, ne njohim premisën kryesore të Paqes Kantiane: shtetet demokratike kanë tendencën të jenë më paqësore kundrejt shteteve të tjera demokratike. Si forum rinor pamë se ky rregull i marrëdhënieve ndërkombëtare shkërmoqej në marrëdhënien mes Shqipërisë dhe Serbisë. Duhet të gjenim diçka të

re. Kësisoj menduam se shtetet social-demokrate kanë një mundësi shumë më të madhe për të qenë paqësore kundrejt shtetesh të tjera social-demokrate; partitë dhe forumet rinore social-demokrate kanë mundësinë më të mirë për të qenë paqësore kundrejt partive dhe forumeve të tjera rinore social-demokrate. Zgjidhja ishte e thjeshtë: nëse duam të ndërtojmë miqësi të fortë mes shteteve tona fqinje, nevojitet të kemi një marrëdhënie shumë të mirë me forumin tonë simotër.

Kësisoj, krijimi i Konferencës Beograna buron së pari nga një nevojë e përbashkët ideologjike.


Tematika që zgjodhëm për diskutimin, sfidat e sistemit arsimor, erdhi si një nevojë praktike. Kur diskutuam për krijimin e Beograna, kuptuam se arsimi në të dy shtetet vuan prej simptomash gati të njëjta. Vizioni ynë është të kemi sa më shumë pikëvështrime rinore në lidhje me edukimin, për të ndërtuar një

korpus mendimi që do të shërbejë si një instrument lobimi tek të dy qeveritë tona.

Këto arsye teorike dhe praktike frymëzuan Beogranën. Si një shënim

të fundit, ju uroj mirëseardhjen dhe ju falenderoj të gjithëve. Asgjë nuk do të kishte qenë e mundur pa pjesëmarrjen dhe idetë tuaja. Le t'ia nisim!

Jovana Majstorovic

Marrëdhëniet Ndërkombëtare –
Rinia Demokratike e Serbisë

Po jetojmë në një kohë kur marrëdhëniet mes Serbisë dhe Shqipërisë janë – mund ta them hapur – një sfidë më vete. Edhe kur mendojmë se ndonjë progres është bërë, provokime të reja prej të dyja palëve ndodhin, duke na bërë konfuzë.

Besoj tek një e ardhme më e mirë për dy shtetet tona. Por kjo mund të ndodhë vetëm falë përpjekjes së përbashkët. Pikërisht për këtë krijuam projektin “Beograna”.

Ndërsa isha bashkë me mikeshën time Joleza në Brighton, Mbretëri e Bashkuar, po diskutonim problemet e shteteve tona sipas pikëvështrimit të të rinjve të të dyja vendeve. Mund të imagjinoni edhe vetë se gjetëm më shumë të përbashkëta mes dy shteteve tona sesa mendonim në fillim.

Ideja jonë kryesore qëndron tek


fakti se nëse punojmë bashkë, nëse takojmë njerëz dhe ndërtojmë politika përbashkuese, mund të shkatërrojmë paragjykimet që na janë imponuar nga media dhe shoqëria.

Besoj tek një e ardhme më e mirë për rajonin, kooperim më të shëndetshëm prej shteteve tona dhe një të ardhme më të begatë brenda Bashkimit Europian.

Besoj se komunikimi, të folurit e sqarë, shkëmbimi i dijeve dhe aftësive, janë e vetmja mënyrë që na çon drejt suksesit.

E ardhmja e Serbisë dhe Shqipërisë është në duart tona. Jam e sigurt se do të jemi aq të fortë sa të respektojmë të shkuarën dhe diferencat, duke imponuar tolerancë dhe solidaritet si virtyte kryesore të luftës sonë për një të ardhme më të mirë.

Arnold Grabocka

Forumi Rinor Eurosocijalist i
Shqipërisë

Sipas Presidentit Lincoln, studentët e brezit tonë do të jenë udhëheqësit e brezit që vjen. Kjo, në një mënyrë simpliste, ilustron dinamizmin dhe kalimin nga një gjeneratë në tjetrën, ose më mirë, transformimin e moralitetit nëpërmjet edukimit. Ky transformim mund të shtrembërojë ose përmirësojë moralitetin, pra cilësinë e qeverive të ardhshme.

Duke adaptuar citimin simplist të Presidentit Lincoln me trendet e reja globaliste dhe internacionaliste, mund të themi se “*Studentët e gjeneratës tonë mund ose mund të mos jenë Komisionerët e gjeneratës tjetër.*” Me termin “Komisioner” nënkuptoj nëpërmjet simbolizmit jo vetëm gjithë strukturën e Bashkimit Europian, por edhe internacionalizmin si doktrinë e aplikueshme. Ky transformim nëpërmjet internacionalizmit dhe globalizmit zhvendos dinamikën e tregut lokal. Tregje të reja shfaqen dhe ndërlihen

nëpërmjet rregullimeve direkte dhe indirekte me tregun ekzistues.

Kjo ndërlidhje e re midis tregut lokal dhe tregut ndërkombëtar mund të jetë dylojëshe:

a. Shok-terapeutike; b. Gradualiste

Përqasja shok-terapeutike e dy tregjeve të punësimit me njëra-tjetrën mund të variojë në efekte. Mund të jetë revolucionare ose kaotike. Kur papritmas tregu i përbashkët i prezantohet një komuniteti/shteti që nuk ka eksperiencë të mëparshme në këtë fushë, dy reagime mund të lindin: nëse tregu lokal ka qenë meritokratik dhe i qëndrueshëm, kontakti shok-terapeutik me tregun e përbashkët do të jetë komplementar; performanca do të rritet, studentët do të përmirësohen, dhe do të ketë një rrjedhshmëri të shëndetshme idesh.

Kur tregjet lokale kanë qenë të damkosura prej nepotizmit dhe admi-

nistratës shtetërore joeficiente, qasja shok-terapeutike do të jetë shkatërrimtare. Ky është rasti i Shqipërisë.

Edukimi në Shqipëri është damkosur prej nepotizmit dhe ineficiencës. Integrimi European dhe Statusi i Vendit Kandidat për në BE tregojnë realisht efektet e rrezikshme të shok-terapisë së tregut të përbashkët europian. Pikërisht për këtë duhet të veprojmë sa më shpejt.

Çfarë duhet të bëjmë?

Së pari, duhet të pranojmë se tregu ynë lokal i punësimit është inefektiv, i sëmurë, i korruptuar. Duhet ta pranojmë këtë konstatim dhe të bëjmë


paqe me veten.

Së dyti, duhet të kuptojmë se impakti shok-terapeutik në rastin tonë mund të sjellë efekte katastrofike.

Së treti, ka nevojë të fillojmë një tranzicion mes shok-terapisë dhe gradualizmit. Si mund të bëhet kjo? Nëpërmjet transferimit sistematik dhe gradual të simptomave prej tregut të përbashkët të punës, në tregun lokal të punës. Çdo muaj dhe vit duhet të sjellim disa risi në sistemin tonë të edukimit. Vetëm kështu mund të shmangim shkatërrimin nëpërmjet internacionalizmit.

Aleksandra Božić

Rinia Demokratike e Serbisë



Sot do të flasim në lidhje me problematikat kryesore të sistemit të edukimit në shtetet tona si dhe në lidhje me sfidat kryesore të tregut të punësimit dhe konkurrencës mes studentëve që vijnë nga fakultete dhe universitete të ndryshme. Sipas të dhënave të vitit 2010, 97% e serbëve dinë shkrim dhe këndim. Buxheti mbi arsimin është 4.7% i GDP. Serbia po humb betejën e largimit të kapaciteteve intelektuale, ndërkohë që të rinjtë preferojnë të gjejnë kushte më të mira jetese dhe punësimi në shtete të tjera. Për momentin në Serbi arsimi fillor është i detyruar, dhe një nga propozimet kryesore të partisë sonë në zgjedhjet e fundit elektorale ishte që arsimi i mesëm të jetë i detyrueshëm po ashtu. Për shkak të rezultateve elektorale, nuk patëm mundësinë të implementojmë këtë propozim.

Vitin e fundit, Ministria e Edukimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik

krijoi një Strategji e cila vendos piketa deri në vitin 2020. “Strategjia 2020” ka piketa të përcaktuara të cilat duhet të realizohen brenda vitit 2020, nën moton “Mësim Gjatë Gjithë Jetës”. Problemi parësor i sistemit arsimor në Serbi janë diplomat e bleat të doktoraturës, plagjarizmi dhe universitetet private të cilat janë krijuar vetëm për shitblerje diplomash.

Në Serbi ka një ndryshim të madh mes universiteteve publike dhe private. Tani kemi 8 universitete publike të gjendura në 6 qytete të ndryshme dhe 12 universitete private. Sipas Kushtetutës, sektori publik dhe ai privat duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, por nuk ndodh gjithmonë kështu. Sipas Komisionit të Akreditimit, gjithë këto universitete kanë përmbushur kriteret, pra në këtë kuptim ato janë të barabarta. Nëse futim në ekuacion situatën aktuale dhe gjithë spekulimet, studentët të cilët janë në një gjendje


shumë të vështirë për shkak të imazhit të keq që këto universitete kanë fituar prej zgjedhjeve dhe strategjive të gabuara. Ka patur disa reforma, por ende nuk ka rezultate të frytshme.

Pas diplomimit studentët ballafaqohen me problemet e mungesës së eksperiencës, meqenëse internship-et nuk janë të detyrueshme përgjatë studimeve. Nga pikëvështrimi i një studenti që ka ndjekur edhe edukimin publik, edhe atë privat, mund të them se nuk ka ndonjë ndryshim të madh kur krahasoj dijen e gjeneruar. Megjithatë ka ndryshime të mëdha kur vjen fjala tek përqasja dhe strategjia që profesorët ndjekin në edukim. Fakultetet gjenden shpesh

të gatshme për të krijuar ndërlidhjen mes studentit dhe internship-it, por kompanitë serbe nuk janë ende të gatshme të pranojnë në gjirin e tyre një numër kaq të madh studentësh. Për shembull, Fakulteti i Drejtësisë dhe Fakulteti i Ekonomisë pranojnë 3000 studentë në vit. Ky kapacitet studentor nuk është i harmonizuar me nevojat e tregut të punësimit. Që në vitin 2012 Serbia ka implementuar një projekt të quajtur “Mundësia e Dytë”. Ky projekt u ndërtua për ata që nuk kanë edukim fillor dhe përmirëson shanset e tyre në tregun e punësimit. Gjysma e numrit të aplikantëve ishin romë.

Romildo Kokthi

Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë



Mund të themi se edukimi është faktori parësor që ndikon në ekzistencën e shoqërisë demokratike.

Ajo çfarë bashkon dy shtetet tona është ndryshimi i papritur i sistemit, i cili ndodhi brenda disa muajsh ose vitesh. Në këtë periudhë kohore, meshkujt dhe femrat e lindur dhe rritur në një sistem komunist, papritmas u katapultuan në det pa kompast, pa përgatitje të qenësishme në lidhje me sfidat që do të përballnin në sistemin kapitalist. Të gjithë e dimë si përfundoi: emigracion, varfëri dhe luftëra; çështje tek të cilat nuk do të fokusohem pasi të gjithë i kemi njohur dhe analizuar.

Dëshiroj të vendos theksin tek papërshtatshmëria e sistemit socio-ekonomik të shtetit tim. Papërshtatshmëri jo vetëm për shkak të politikave të qeverive të mëparshme, por edhe për shkak të angazhimit të ulët social. Një shoqëri e cila në shumë aspekte mbetet e lidhur me historinë e 50

viteve më parë. Një shoqëri e cila nuk di si të rinojë veten. Një shoqëri në të cilën kultura ka mbetur 23 vjet në të shkuarën, duke përfshirë një mentalitet të vjetruar e të ndërthurur me sistemin kapitalist.

Është e qartë se ndryshimi nuk mund të jetë ‘i mprehtë dhe i shpejtë’. Kjo ndodh për shkak të përballjes sonë me shtresëzimin breznor të ideve.

Do të ishte shumë e thjeshtë të thoshim se të rinjtë janë e ardhmja, ose se shoqëria mund të ndryshojë duke u lënë atyre hapësira të nevojshme. Megjithatë zgjidhja e duhur është garantimi i edukimit cilësor për të rinjtë. Ne e dimë se pa arsimim cilësor, jo vetëm që nuk mund të përballemi me tregun e punësimit, por nuk mund të jemi as pjesëmarrës aktivë në çështjet më të rëndësishme sociale.

Nëpërmjet edukimit të duhur nuk nënkuptoj vetëm modelin e trajnimit

apo studimet e doktoraturës, të cilat synojnë të ndërtojnë profesionistë të rangut të lartë. E kam fjalën për arsimin e detyrueshëm në nivelet më të ulëta. Këtu dua të fokusohem tek veprimet e një qeverie të përgjegjshme.

Të diplomuarit më të mirë të gjimnazëve do të bëhen të diplomuarit më të mirë të universiteteve, dhe ata që nuk do të futen nëpër universitete do të jenë gjithsesi në gjendje të ndjekin edukim të specializuar dhe konkurrencial për tregun e punësimit.

Kësisoj është e nevojshme jo vetëm të investojmë në edukim, apo të hedhim miliona e miliona në sistemin arsimor, por edhe të kemi një qëllim të qartë. Nëse duam që të kemi rezultate pozitive për të ardhmen, këto qëllime duhet të jenë specifike dhe të përgjegjshme. Theksi duhet vendosur tek edukimi profesional dhe teknik, pasi jo gjithëkush ka të njëjtën prirje apo talent.

Niveli i papunësisë në Shqipëri është 14%. Kjo është një e dhënë alarmuese sepse rrezikojmë polarizimin social, i cili deri më tani ka qenë pjesërisht i mbështetur prej celulës së familjes. Nëse nuk bëjmë asgjë në lidhje me këtë, do të përforcojmë konfliktet sociale, të cilat janë një rrezik real për sistemin demokratik.

Përgjatë 20 viteve të fundit, qeveritë

e mëparshme kanë investuar shumë pak në sistemin arsimor. Më keq se kaq, kanë munguar në mënyrë tërësore reformat në arsim. Kjo lloj politike na ka çuar në situatën aktuale. Sot ne kemi një numër të stërmadh të diplomuarish inkompetentë.

Ajo çka dua të theksoj është se jo gjithkush mund të bëhet doktor, avokat, ekonomist apo inxhinier. Disa prej të rinjve do të jenë hidraulikët e rinj, mekanikët, artizanët. Duhet të bëhet e qartë se këto profesione janë jo vetëm dinjitoze, por edhe vitale. Ato janë një mënyrë pjesëmarrje në jetën sociale, si pararendëse e arritjeve vetjake. Është më dinjitoze të jesh një marangoz i mirë, sesa një doktor i keq. Dua të theksoj faktin se në shtetet e tjera europiane, ka pasur një mungesë të theksuar burimesh njerëzore në profesione specifike (të lartpërmendurat).

Shqipëria dhe Serbia janë kandidate zyrtare për aderimin në Bashkimin European. Me gjasa aderimi i plotë i secilës do të ndodhë në kohë dhe modalitete të ndryshme, por rezultatet përfundimtare janë të qarta që tani. Ajo çka duhet të bëjmë, sipas meje, është përshtatja e perspektivës europiane.

Krahasuar me vende më të zhvilluara si Franca, Anglia apo Gjermania, GDP respektive e të cilave është \$3. 048

miliardë, \$2. 204 miliardë dhe 2. 330 miliardë, GDP e dy shteteve tona është \$24 miliardë për Shqipërinë dhe \$83 miliardë për Serbinë.

Përshtatja e perspektivës europiane nënkupton fillimin e kooperimit që tani, për të krijuar një treg ballkanik të unifikuar dhe për të eliminuar barrierat në lëvizjen e prodhimeve. Në këtë mënyrë mund t'i përfaqësojmë Bashkimin European si partnerë ekonomikë, duke tejkaluar vështirësitë që lindin nga ekonomitë e vogla brenda tregut të madh europian.

Edhe qeveritë tona duhet të orientohen

drejt sistemit arsimor. Duhet të kemi një studim të qenësishëm të këtij tregu. Tregu i punësimit është fleksibël dhe mund formëzohet nëse arrijmë edukimin e duhur. Dimë se së fundi vendi jonë ka filluar një rrugë të mirë në profesione të caktuara si producent, ekspert cilësie, ekspert marketingu turizmi, ekspert doganash e kështu me radhë.

Si përfundim, dua të them se përveçtesimi i një perspektive vizionare në sektorin e arsimit si dhe parashikimi i zhvillimeve të tregut janë çelësi perfekt i suksesit.

Predrag Stankovic

Rinia Demokratike e Serbisë



Të nderuar miq, në dy ditët e fundit ne kemi dëgjuar për mjaft probleme të përbashkëta me të cilat ndeshen Serbia dhe Shqipëria. Tani është koha për t'u vënë në lëvizje dhe për të gjetur një zgjidhje. Ideja ime është që të formojmë një grup, të përbërë nga serbë dhe shqiptarë, me një qëllim të përbashkët; të ndërtojmë besim. Besimi është një element thelbësor në krijimin e çdo marrëdhënieje. Nëse e arrijmë këtë gjë do t'a kemi mjaft të lehtë që të bëjmë biseda të zgjuara, të cilat përfundojnë me mirkuptim dhe me një shtrëngim duarsh. Por, është ende e rëndësishme që të ndërtojmë ura ndërmjet dy popujve të ndryshëm bazuar në tre pika:

-Transparencë: Të themi të vërtetën, në mënyrë që njerëzit të bëjnë verifikime dhe të testojnë vetveten.

-Mbajtja e premtimeve: Bëj atë për të cilën zotohesh se do t'a bësh.

-Beso tek të tjerët: Përçoje besimin tënd tek skuadra jote dhe ata do të t'a kthejnë këtë besim tek ty.

Besimi i cili mund të ndërtohet për shumë vite mund të kriset brenda pak minutave.

Sfida e parë është përballja me skuadrat e projekteve dhe me personat e interesuar, në mënyrë që të identifikojmë një nivel pragmatik të besimit mbi individët që do të kenë dëshirë të bëhen pjesë e kësaj ideje. Pasi të bëhemi miq, ne duhet të përcaktojmë qëllimet tona. Që të kemi qëllime të përbashkëta duhet të definojmë se cilat janë qëllimet tona. Qëllimet përgjithësisht mund të ndahen në afatgjata dhe afat-shkurtra. Qëllimet afat-shkurtra mund të përfshijnë edhe mirëkuptimin midis dy personave. Ndërsa tek qëllimet afat-gjata mund të futen gjëra të rëndësishme si për shembull anëtarësimi në BE. Nëse

ambiciet janë të larta dhe pjesëmarrësit janë të gatshëm për të punuar jam i sigurt që në mund të arrijmë diçka. Në fillim mund të përcaktojmë disa objektiva lehtësisht të arritshëm

në mënyrë që të na ngrihet morali. Mund të fillojmë me problematika si punësimi. Pas kësaj mund t'a shtrijmë aktivitetin tonë në mjaft fusha të tjera.

Denada Male

Forumi Rinor Eurosociet i
Shqipërisë

Jam këtu sot për t'ia adresuar këtë fjalim edukimit publik. Është në besimin tim se një popull i arsimuar krijon një rrugë më të qartë për të ardhmen e tij. Kjo rrugë natyrisht shkon drejt së ardhmes me shpresën se e ardhmja do të jetë e ndritur.

Ka ardhur koha për shqiptarët që të mos pyesin më se çfarë mund të bëjë vendi i tyre për ta, por se çfarë mund të bëjnë ata për vendin e tyre. Në këto kushte, ndërmerren hapa mjaft progresivë. Drejtësia dhe mirëqenia sociale nuk duhet të qëndrojnë më si nocione që vetëm i dëgjojmë në media. Ne duhet të ndërtojmë një urë lidhëse mes tyre dhe edukimit.

Për arsye të drejta, mirëqenia sociale është mjaft e ndërlidhur me sistemin tonë arsimor. Deri më tani, edukimi mbetet diçka të cilën duhet t'a kultivojmë në mënyrë që të rrisim ndjenjën e përgjegjshmërisë si qyte-

tarë. Kur them qytetar, nënkuptoj të qenit një qytetar i Shqipërisë, i Europës madje dhe i botës. Edukimi na forcon aftësitë tona të komunikuarit dhe na rrit vullnetin për të komunikuar me të tjerët. Ky është hapi i parë i zgjidhjes së problemeve.

Problemet. Këtu nuk kemi të bëjmë me një botë fantastike, për të qenë të sigurtë. Shqipëria, si çdo vend tjetër ka problemet e saj. Sistemi ynë arsimor është një problem mjaft i madh. Shohim mjaft padrejtësi dhe zhgënjime në të. Shohim mjaft studentë cilësorë të cilët e humbasin mundësinë për t'u bërë dikushi pasi për arsye të ndryshme nuk kanë mundësi të ndjekin shkollën. Një rini e paedukuar mirë nuk premtion shumë. Një vend që nuk krijon mundësi të barabarta shkollimi nuk premtion shumë.

Aktualisht, Shqipëria është në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE. Shtetasit

tanë do të behën konkurrentë të mirë të tregjeve europiane nëse gjejnë tek vetja disa potenciale. Për shembull, ne mund të reklamojmë tek europianët disa punime artizanale të cilat i kemi të trashëguara brez pas brezi, nga babai tek djali. Mundësitë janë të pafundme. Arti mund të përdoret në shumë mënyra.

Një problem tjetër madhor për arsimin shqiptar është mosnjohja e diplomave. Ndodh rëndojmë që një student që ka studiuar në Shqipëri të mos pranohet në një mundësi punësimi jashtë shtetit pasi diplomat shqiptare nuk njihen. Ky është një fakt disi i çuditshëm pasi universitetet tona kanë adoptuar të njëjtat programe studimi me shtetet e BE-së. Cili është problemi? Nuk janë të besueshëm universitetet tona?

Ne kërkojmë një mirëqenie sociale me të mirë në mënyrë që të mos vëmë në rrezik brezat e së ardhmes. Reformimi i sistemit mund të jetë një start shumë i mirë. Mirëqenia sociale

nënkupton një shtet të përmirësuar. Duke folur në gjuhën ekonomike, hapësira midis dhjetë përqindëshit më të pasur dhe dhjetë përqindëshit më të varfër në vendin tonë është mjaft e madhe. Shtresa e varfër e shoqërisë jeton me më pak se dy dollarë në ditë. Ky është një problem madhor i shumë familjeve shqiptare.

Përmirësimi i sistemit arsimor duhet të jetë një prioritet për vendet tona. Kjo konferencë është një provë që tregon interesim dhe dëshirë. Nuk do të duhet shumë që të veprojmë. Duhet të fillojë nga diku. Unë ju ftoj të gjithëve që të filloni të veproni në vendet ku jetoni, duke qenë më pranues ndaj ideve të ndryshme, duke qenë më të vullnetshëm për të dëgjuar dhe më të kuptueshëm për të bashkëpunuar. Duhet të keni parasysh diçka. Një vend nuk është as i imi, as i yti, por është i të gjithëve.

Stefan Josimov

Rinia Demokratike e Serbisë



Sistemi edukativ është një komponent esencial në çdo shoqëri. Është diçka e nevojshme. Në Serbi, gjatë njëzet viteve të fundit është investuar shumë pak në arsim, ndikuar ndoshta edhe nga situata e vështirë ekonomike në të cilën ndodhet vendi. Mund të them se shteti është përgjegjës për këtë dhe njerëzit duhet të kërkojnë një nivel më të lartë arsimit. Shteti ynë kërkon një ndryshim thelbësor në të gjithë sistemin arsimor. Por, përpara se të flasim për edukim cilësor, le të flasim për probleme me të cilat njerëzit përballen përpara se të edukohen. Fillimisht, në Serbi një i ri duhet të paguajë për disa provime përpara se të futet në kolegji, ku përfshihen taksa, verifikim dokumentesh, etj. Pas kësaj, vjen kostoja e universitetit, e cila varion nga 1. 000 deri në 2. 500 euro në shtet dhe nga 3. 300 euro dhe lart në arsim privat. Me një shkallë papunësie 30%, shkollimi vihet në kushte disi të vështira, për të mos

thënë të pamundura. Zgjidhja është padyshim një shkollim falas, por duke njohur situatën ekonomike mund të them se diçka e tillë është e pamundur.

Sa i përket kualitetit të edukimit, ne jemi krenarë që kemi shumë segmente shkollore të cilat i përkasin një niveli mjaft të lartë. Gjithsesi, në krahun tjetër, mund të themi se kemi një numër mjaft të lartë të personave të cilët janë adresuar drejt arsimit profesional. Megjithatë, edhe për këta kërkohet një treg më i mirë pune.

Edukimi mund të bëhet motori kryesor që do të drejtojë stabilitetin ekonomik në Serbi. Mendoj se mund t'a ngremë nivelin arsimor duke angazhuar disa ekspertë për pesë ose dhjetë vite. Me ndihma nga BE-ja mund të shkojmë përpara. Këto lloj reformash mund të sjellin përmirësime rrënjësore në jetën e të rinjve të vendit tim.

Sonil Frashëri

Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë



Edukimi si ndërtues i urave të bashkëpunimit dhe i largimit të paragjyqimeve midis dy vendeve

Përhëndetje të gjithëve. Para së gjithash, do të doja t'iu falenderoja për prezencën tuaj këtu në Shqipëri. Jam shumë i lumtur duke përshëndetur këtë iniciativë të të rinjve serbë dhe shqiptarë për të organizuar një konferencë të tillë dhe shpresoj që ky të jetë një hap i madh bashkëpunimi midis organizatave të tilla, pse jo edhe për të gjitha forumet e majta të Ballkanit. Kjo konferencë ka të bëjë me forcimin e bashkëpunimit midis të rinjve të një kahu politik përmes edukimit. Kjo konferencë, sipas meje, do të shërbejë në krijimin e një epoke të re ku të rinj nga vendet tona do të përballen me probleme të përbashkëta dhe do të mundohen zgjidhje të përbashkëta, me perspektivën për të lëvizur përpara. Edukimi është një proces mjaft i rëndësishëm i cili na

ndihmon që të përballemi me sfida të ndryshme. Sfidat kanë nevojë gjithmonë për mendje të hapura dhe bashkëpunuese. Gjithçka fillon me shkëndija të vogla, si konferenca jonë.

Ballkani ka qenë gjithmonë një rajon mjaft i paragjykuar si pasojë e historisë. Rreth 100 vite më parë, këtu filloi Lufta Botërore, ku shumë njerëz u vranë me njëri tjetrin. Ka qenë një hapësirë e mbushur me mendje që nuk flasin, me mendje të mbyllura. Këtë vit, fatmirësisht, ne kemi mundësi që të flasim hapur. Si ballkanas, ne duhet të kuptohemi me njëri tjetrin. Jemi më të fortë nëse bashkëpunojmë në çështje të ndryshme si ekonomike, sociale, etj. Ballkani ka një popullsi prej afro 50 milionë banorësh. Jemi një figurë mjaft e konsiderueshme në terren për çdo kompani. Jemi 50 milionë konsumatorë. Por, duhet të jemi 50 milionë njerëz që bashkëpunojnë. Arsimimi mund të na e mundësojë

mjaft lehtë këtë gjë. Jemi një rajon me mijëra vite histori dhe kemi nevojë për një shkëmbim kulturor. Duhet të njihemi me njëri tjetrin. Është koha që universitetet e vendeve tona të punojnë në të njëjtin drejtim.

Nga ana tjetër, ne duhet të operojmë si një treg i vetëm në mënyrë që të jemi më të fuqishëm. Duhet të bashkëpunojmë në gjithçka. Urat e bashkëpunimit janë shumë të nevojshme për t'a bërë Ballkanin një vend më të mirë. Çfarë na ndan ne? Kjo është një pyetje paksa e vështirë. Unë nuk po mundohem të them që ne flasim gjuhë të ndryshme dhe kemi kulturë të ndryshme. Ne na ndajnë disa paragjyime idiote të cilat vijnë si pasojë e një mentaliteti idiot nacionalizmi. Ne e paragjykojmë njëri tjetrin jo sepse e mësojmë në shkollë, por sepse dikush që është i verbër në mendime sa i përket superioritetit kombëtar na e thotë. Shumë njerëz janë lënduar nga këto mendime të prapambetur. Kjo gjë është e gabuar dhe duhet të ndryshojë. Ne duhet t'a shohim njëri tjetrin si njerëz në radhë të parë. Duhet të ushtrojmë mbi njerëzit tanë mekanizma që do t'u nxisin atyre ndërgjegjen. Duhet të bashkëpunojmë me universitetet e vendeve tona. Shkëmbimi kulturor


dhe edukativ është diçka mjaft e mirë. Duhet të stimulojmë projektet multi-etnike duke i dhënë një shans të rinjve që të komunikojnë me njëri tjetrin. Paragjykit duhet të zhduken.

Edukimi multikultural duhet të penetrojë një rang të madh aktivitetesh duke promovuar dhe implementuar disa vlera demokratike si drejtësia sociale, barazia, toleranca, reduktimi i paragjyimeve dhe vlerësimi i diversiteteve. Parandalimi i paragjykit është një shqetësim konstant. Ndryshimet në sistem mund të shtyjnë drejt aktivizmit social. Shkollat janë komponentët më potencialë që mund t'a arrijnë diçka të tillë. Duke dhënë si shembull një model të përmirësuar, studentët mund të jenë një gjendje që realisht t'i vërejnë problemet e lartpërmendura. Tek studentët mund të nxitet mendimi kritik. Deri sa tensionet do të jenë gjithmonë të pranishme në diferencat etnike, kombëtare, linguistike dhe kulturore do ta kemi pak të vështirë që të relacionohemi me njëri tjetrin.

Mos harroni, jemi në prag të pranimit në BE.

Stefan Simic

Rinia Demokratike e Serbisë




Në një shoqëri moderne është e pamundur që të arrish një mirëqenie sociale pa një përqindje të lartë të popullsisë së përfshirë në sistemin arsimor. Në Serbi situata nuk është premuese. Duke iu referuar censusit të vitit 2012, ka progres në raport me situatën e dhjetë viteve më parë, por këto rezultate janë larg stadiit për t'u cilësuar si të kënaqshme. Në Serbi, 14% e popullsisë nuk ka fare arsimim, 11 e popullsisë nuk e ka mbaruar shkollën fillore dhe vetëm 11% e popullsisë ka arsim të lartë. Mbi 50% e individëve nuk e përdorin kompjuterin. Përqindja e popullsisë që ka përfunduar universitetin është mjaft e ulët, krahasuar me shifrën 40%, që është njëkohësisht edhe objektivi që BE na ka caktuar për t'a përmbushur brenda vitit 2020. Reformat në arsimin

e lartë po kthehen në reforma që nuk mbarojnë asnjëherë. Gjithashtu, këto reforma nuk prodhojnë gjë tjetër veçse rritje të kostove të studimit.

Është e qartë që Serbia, si një ish-vend socialist ka tradita në edukimin publik, por ajo duhet që të përdorë resurset aktuale dhe të përpiqet që të stabilizojë situatën ekzistente në të cilën ndodhet arsimi. Duhet të lëvizim hap pas hap në mënyrë që të bëjmë përpara. Besoj se arsimi elementar duhet të jetë i detyrueshëm për të gjithë. Diçka që më shqetëson është fakti se në Serbi po gjejnë mbështetje të madhe ideologjitë populiste dhe nacionaliste. Politikat progresiste, dhe nxitja e marrëdhënieve të mira me fqinjët kanë një përkrahje të lehtë. Është pak e vështirë për të rritur mirëqenien sociale në këto kushte.

Alban Nako

Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë



Unë besoj tek edukimi. Pa një edukim cilësor, unë nuk do të isha këtu mes jush sot, duke mbajtur një fjalim në gjuhën angleze. Të mësuarit është një proces që zgjat një jetë. I gjithë procesi i jetës sociale nënkupton që individët dhe grupet sociale mësojnë në mënyrë konçize për të zhvilluar kualitetet e tyre personale, aftësitë dhe njohuritë për të mundësuar benefite për komunitetet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Sot ne përballemi me një sfitë! Një sfidë të cilën gjenerata jonë duhet t'a fitojë. Jam mjaft i lumtur që t'iu informoj se një reformë mbi arsimin e lartë është në prag të nisjes në vendin tonë dhe kjo është diçka mjaft pozitive. Një tjetër gjë e mirë për këtë Reformën është se, arsimi ka filluar të lërë mënjanë kuptimin e ndarjes tradicionale në universitetet shtetërore dhe universitetet private, duke konverguar nocionin e universiteteve publike.

Një edukim më cilësor në Shqipëri, si

në çdo shtet tjetër, përkthehet në një shërbim publik dhe në një të mirë publike. Kjo gjë promovon edhe disa principe të edukimit siç janë barazia e mundësive, kompeticioni i lirë dhe mbi të gjitha, të qenit një shërbim publik.

Është shumë e rëndësishme për të menduar rreth një sistemi arsimor të unifikuar dhe të standardizuar. Kjo iniciativë mund të krijojë shumë mundësi për një përfaqësim më dinjitoz dhe konkurrues në “tregjet” rajonale dhe europiane.

Arsimi i lartë duhet t'iu përgjigjet në një farë mënyrë edhe ndryshimeve të tregut të punës. Duke realizuar këtë gjë, ne jo vetëm që ngremë premisat për një edukim që relacionohet me kërkesat e tregut, por krijojmë në një farë mënyrë edhe një strategji zhvillimi.

Arsimi i lartë në Shqipëri duhet të mbetet një shërbim publik dhe si i tillë shteti është garantuesi kryesor i

këtij parimi, në bazë të disponimit të tanishëm kushtetues. Edhe pse shteti do të jetë garant kryesor i arsimit publik dhe do të përcaktojë drejtimet kryesore të zhvillimit, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se shteti do të jetë sponsori i tij i vetëm. Institucionet publike të arsimit të lartë nuk kanë autonomi Kushtetuese, e cila duhet të jetë e garantuar në bazë të legjislacionit aktual në fuqi. Dispozita kushtetuese nuk garanton mekanizma efektive të menaxhimit të suksesshëm në mënyrë që të ofrohet një cilësi në arsim dhe në zhvillimin aktual të shoqërisë. Në anën

tjetër, arsimi i lartë jo-publik nuk solli asnjë nga pritshmëritë që lidheshin me përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë. Koncepti i ri i „universiteteve publike“ nuk duhet të interpretohet se format ekzistuese të arsimit nuk do të lejohet më.

Ne përballemi me një sfidë. Ne jemi të ndërgjegjshëm dhe të vetëdijshëm për rëndësinë e vendimeve tona. Zgjidhja që ne ofrojmë nuk mund të jetë e përsosura, por ne besojmë në atë që kemi mësuar deri tani. Ne besojmë në arsim.

Milica Glisic

Rinia Demokratike e Serbisë



Sistemi arsimor është fotografia më e plotë e një shoqërie. Sistemi modern arsimor, duke qenë i tillë, duhet të garantojë disa kushte të barabarta socio-ekonomike për të gjithë ata që janë të interesuar në ndjekjen e studimeve. Tranzicioni nga fusha e arsimit të lartë në tregun e punës është vendimtar për riprodhimin e pabarazisë sociale, sidomos në arsimin si një mekanizëm themelor dhe si kanalin e lëvizshmërisë shoqërore. Dallimet në mes të rinjve rrjedhin nga pozita e tyre sociale dhe ata janë në lidhje të vazhdueshme me opsionet e ndryshme fillestare.

Kalimi nga ekonomia e centralizuar në një treg të hapur, natyrisht që ndikoi edhe në hapjen e universiteteve të reja private. Gjithashtu, kostoja për të qenë pjesë e një universiteti privat nuk ishte më 0. Këto kosto, të cilat rriten pas çdo viti, shpesh herë janë të papërballueshme nga ana e studentëve. Çmimi që ata duhet të paguajnë për

ndjekjen e studimeve të larta konstaton në 450 për shkollim dhe 2500 euro për jetesën. Këto janë shifra relativisht të larta duke qenë se një familje serbe ka mesatarisht 400 euro të ardhura për muaj. Tarifat e studimit sjellin një farë diskriminimi ose pabarazie, duke qenë se familjet e varfra nuk kanë mundësi ekonomike për t'i përballuar ato. Gjithashtu, studimi kthehet në një luks vetëm për njerëzit e pasur. Arsimimi i dobët është një nga faktorët kyç të riprodhimit të pabarazisë sociale, si dhe një ndër barrierat më të mëdha të tregut të punës. Njerëzit me arsim të ulët janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të larta të papunësisë dhe gjendjes së pafavorshme të punës. Gjithashtu, ata janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të larta të varfërisë. Prandaj përvetësimi i njohurive dhe aftësive të duhura bëhet një parakusht i nevojshëm për punësim më të mirë.

Një tregues i rëndësishëm i cilësisë dhe i efikasitetit të sistemit arsimor është disponueshmëria e arsimit për kategoritë e rrezikuara të popullsisë, që për një arsye apo për një tjetër, nuk kanë mundësi të barabarta me të tjerët. Këtu futen fëmijët në fshat, fëmijët me aftësi të kufizuara ose me nevojë

të veçanta, fëmijët që rrjedhin nga familje të varfra, etj. Gjithçka duhet të fillojë me thënien humane, “mundësi të barabarta për të gjithë”. Në atë mënyrë ne nuk mund të humbasim ndonjë talent apo ndonjë person i cili është mjaft i vullnetshëm në dhënien e kontributit të tij për shoqërinë.

Alban Avdullai

Forumi Rinor Eurosocijalist i Shqipërisë



Arsimi është thelbësor për përparimin e shoqërisë dhe si i tillë është mjaft i rëndësishëm për çdo vend rreth globit. Shumë shtete e konsiderojnë arsimin si një prej investimeve më të mëdha të politikave të tyre. Edukimi perceptohet si një çelës që mund të zgjidhë mjaft probleme që njeriu has në jetën e tij.

Edukimi është parë gjithashtu si një indigrent kryesor në kooperimin midis shteteve, çka do të ishte një mënyrë për të sjellë stabilitet dhe mirëkuptim midis shteteve fqinje dhe mes tyre që ndoshta ndodhen edhe me larg njëri tjetrit. Në momentin që flasim, kemi shumë nevojë për të krijuar marrëdhënie të reja midis Shqipërisë dhe Serbisë.

Duke u fokusuar në sistemin tonë arsimor, mund të them se Shqipëria nuk ka bërë shumë. Shteti nuk i ka dhënë rëndësinë e duhur shoqërisë dhe si rrjedhojë kanë derivuar jo pak probleme.

Problemet:


1. Për shumë vite Shqipëria i ka dhënë më shumë rëndësi sasisë në raport me cilësinë. Gjatë qeverisjeve të shkuara, në vendin tonë, çdo ditë që kalonte e rëndonte edhe më shumë sistemin arsimor. Kjo do të thotë se një numër i madh studentësh i drejtoheshin universitetit, por shumë pak prej tyre ishin produktivë.
2. Mungesa e orientimit të nxënësve për degë të rëndësishme të universiteteve, për të cilat ka edhe një interesim nga tregu i punës është një tjetër problem serioz. E drejta për të studiuar është një e drejtë themelore për të gjithë, por qeveria duhet të veprojë në përputhje me këto të drejta për të stimuluar progresin ekonomik. Vitet e fundit ka pasur një mungesë të madhe të orientimit të studentëve për të marrë degë të rëndësishme të shkollave që janë jashtëzakonisht të rëndësishme për tregun e punës.

3. Mungesa e profesionistëve në fusha të ndryshme dhe papunësia vazhdojnë të mbeten dy probleme serioze. Neglizhenca e treguar ndaj sistemit arsimor e ka kthyer këtë të fundit si një mundësi që shërben vetëm për të marrë një diplomë dhe jo si një mundësi që të rrit profesionalisht. Shumë studentë që diplomohen nuk janë vërtet të aftë për tregun e punës.

Duke u fokusuar në këto situata problematike të krijuara në vendin tonë, unë do të doja të nxisja bashkëpunim me ju në mënyrë që gjejmë disa zgjidhje të përbashkëta. Në këtë mënyrë ne do të mund të vëmë në vijë të drejtë një sërë shqetësimesh që janë të vlefshme për të dyja vendet, si për Shqipërinë, ashtu edhe për Serbinë.

Boris Popovic

Rinia Demokratike e Serbisë



Janë gjithsej tre probleme madhore me të cilat Serbia ballafaqohet çdo ditë në lidhje me arsimin dhe tregun e punës:

1. Sistemi arsimor nuk është i harmonizuar me kërkesat e tregut të punës.

Serbia duhet të investojë në reformat e sistemin arsimor sepse të diplomuarit në vend që të gjejnë një punë përfundojnë në agjensitë e punësimit.

Shembuj të mosrespektimit të sistemit arsimor në tregun e punës janë të shumta, të tilla si:

- Mospërputhja e kërkesave të tregut të punës me politikat e regjistrimit në Universitet.

Si rezultat i kësaj mospërputhjeje ne kemi një disproporcion të madh mes numrit të të diplomuarve dhe mundësive të punësimit. Universitetet kanë tendencë që të regjistrojnë sa më shumë nxënës në mënyrë që të

përfitojnë nga ana financiare sepse tarifat e shkollimit janë shumë të larta. Si rrjedhojë cilësia e studimeve nuk është shumë e lartë dhe studentët nuk mund të përfitojnë nga studimet e tyre.

- Një numër i madh universitetesh nuk u mundëson stazhe studentëve gjatë studimeve të.

Si pasojë e kësaj, studentëve u mungon eksperiencia e punës. Ata nuk janë të gatshëm që të marrin përsipër përgjegjësi dhe në këtë mënyrë hasin vështirësi në gjetjen e punëve të ndryshme. Punëdhënësit kërkojnë punonjës me ekperiencë.

Cilat janë zgjidhjet e mundshme për këto çështje?

- Ndryshimi i politikave regjistrimit në universitet

- Futja e stazhit të detyrueshëm për studentët (në nivele të dy shkollave të mesme dhe universitare).

2. Sistemi arsimor është i vjetruar dhe prodhon të diplomuar me aftësi të papërshtatshme

Kjo do të thotë se studentët e sotëm marrin të njëjtën diplomë dhe të njëjtat aftësi që merrnin studentët e njëzet viteve më parë. Kjo i distancon ata nga nevojat e tregut të sotëm të punës. Në Serbi ka patur shumë ndryshime teknike dhe shoqërore. Disa profesione të vjetra janë zhdukur dhe ka një nevojë për profesione të reja. Për shembull: Në industrinë e përpunimit të drurit, punëdhënësit kërkojnë punëtorë që dinë të përdorin makineri moderne, por nxënësit gjatë arsimit të tyre nuk e kanë patur kurrë shansin që të prekin makina të tilla.

3. Sistemi arsimor dhe industria nuk janë në një linjë

Serbia nuk e ka kuptuar ende që sektori kryesor i ekonomisë së saj

është industria. Për të përmirësuar ekonominë, Serbia duhet të punojë në forcimin e industrisë. Ne kemi mjaft potenciale në industrinë e automobilave, në sektorin e bujqësisë, në industrinë e naftës, etj.

Për shembull: Në Kroaci, turizmi është sektori kryesor i ekonomisë. Ata kanë hapur shkolla specifike të cilat trajnojnë studentët për të qenë sa më profesionistë. Ky është një hap i mirë pari Kroacia i njeh mirë potencialet e saj dhe mundohet që të investojë sa më shumë tek prioritetet e saj.

Duhet të përmendet se partitë politike edhe pse flasin shumë për arsimin gjatë fushatave zgjedhore nuk bëjnë shumë pas tyre. Vendi ka nevojë për një plan të qartë për të kapërcyer këto çështje. Është shumë e rëndësishme që të monitorohen sistematikisht trendet e tregut.